



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 6. të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 3 të Rregullës Nr. 03/2013, për Votim Jashtë Kosovës si dhe në bazë të vendimit Nr. 256/2019 i datës 08.04.2019, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e veriut, Zveqan, Leposaviq dhe Zubin Potok, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 19.04.2019 nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Ndryshimin e vendimit të KQZ-së, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore**

- I. Ndryshohet, pika II, paragrafi (n) i vendimit të KQZ-së nr.256/2019, i datës 08.04.2019, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas rregullës zgjedhore Nr.15/2013, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovicë e veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan, që do të mbahen më 19 maj 2019, si në vijim:

**Afati për regjistrim si votues jashtë Kosovës do të filloj me datën 23 prill 2019 dhe do të përfundoj me 30 prill 2019.**

- II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv për zbatimin e këtij vendimi
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 19.04.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



**Valdete Daka**